

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 10 MARS 2022

Referuar të dhënave të INSTAT-it, rezulton që çdo person krijon 1,4 kg mbetje çdo ditë. Po ta shumëzosh këtë të dhënë Kuvendi i me numrin e qytetarëve që banojnë e jetojnë në vendin tonë, atëherë merret me mend sesa e madhe është sasia e mbetjeve që krijohet çdo ditë dhe se çfarë angazhimi serioz kërkohet që këto mbetje të menaxhohen në mënyrën e duhur. Në fakt, kjo duhej të ishte preambula me të cilën duhej të niste diskutimi për menaxhimin e mbetjeve dje, të vijohej sot dhe të projektohet e nesërmja. Parimi “Kush ndot, paguan” është një parim të cilin duhet ta kuptojmë dhe ta vlerësojmë drejt nëse vërtet dëshirojmë një mjedis të pastër për vete dhe brezat që do të vijnë. Përvoja europiane tashmë e ka vërtetuar këtë pohim, ndaj prioritet i Bashkimit European është ekonomia qarkulluese, që ka synim reduktimin e mbetjeve dhe riciklimin. Cila mënyrë e menaxhimit është më e mira, është vetëm një mënyrë? Jo, nuk ka një model dhe asnjë model nuk mund të aplikohet i njëjtë në çdo vend.

E vërteta është se procesi i menaxhimit të mbetjeve është një proces që kushton në të gjithë botën dhe nuk është i lehtë për t’u ndërmarrë, ndryshe do të ishte ndërmarrë që në kohën tuaj, që në 2006-ën, në kohën kur filluan momentet e para të emergjencave mjedisore. Kapacitetet njerëzore janë, gjithashtu, të rëndësishme dhe fjala është për kapacitete profesionale në fushën e mjedisit, kapacitete që munguan në dëgjuesin e një komisioni hetimor të ngritur për vendimmarrje të lidhura me mjedisin.

Publiku që na ndoqi dëgjoi në këtë komision akuza, debate dhe konkluzione paraprake, paçka se organi i akuzës është duke punuar për të vënë përpara përgjegjësisë cilindo që ka shkelur rregullat. Publiku pa se si deputetë të parlamentit të Shqipërisë nuk u kursyen se bëri gjyqtarin, prokurorin, policin, inspektorin, por publiku nuk pati mundësinë të dëgjonte asnjë ekspert mjedisor. Pse? Sepse qëllimi i ngritjes së këtij komisioni nuk ishte për të kuptuar përmes fakteve dhe të dhënave se cila duhej të ishte zgjidhja më e përshtatshme mjedisore për të shkuarën dhe për të ardhmen, por ishte ngjizja e një fabule që duhej të zmadhohej dita ditës me vlera që i takojnë së ardhmes dhe pyetje jashtë fokusit të objektit të veprimtarisë së ngritjes të komisionit hetimor. Megjithatë, janë qytetarët e Elbasanit, Fierit, Durrësit dhe Tiranës, të cilët, ndonëse nuk dëgjuan ekspertë mjedisorë, janë dëshmitarë okularë të asaj se çfarë ishin qytetet e tyre para dhe pas 2013-s në kontekstin e venddepozitimeve të mbetjeve urbane. Pas referimit të shtjelluar, që u bë sot këtu nga zonja Ermonela Felaj, unë mendoj se nuk është e nevojshme të shkojmë në detaje, por dua të mbetem në dy elemente shumë të rëndësishme të përmbajtjes.

Së pari, çfarë rezultonte në Sharrë në vitin 2015, atëherë kur Sharra e mbaroi funksionimin dhe patjetër që lipsej një zgjidhje? Në Sharrë vetëm për vitin 2015 sasia totale e mbetjeve të depozituara nga Bashkia e Tiranës ishte 200 275 tonë mbetje, ndërkohë që Tirana është një qark me sipërfaqe prej 1586 kilometrash katrorë dhe ku, sipas censit të vitit 2016, popullsia e këtij qarku ishte 780 531 banorë. Sikur të bëni një veprim të thjeshtë aritmetikor, sigurisht do ta kuptoni sesa e lartë ishte sasia e mbetjeve të krijuara nga çdo qytetar që jetonte në qarkun e Tiranës. Në vitin 2018 Bashkia e Tiranës ka nënshkruar formën e angazhimit për detyrimet e njësive vendore të qarkut të Tiranës, pas marrjes së miratimit nga këshilli bashkiak në shtator 2017, si dhe miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për

vitin 2018, sipas parashikimeve të nevojshme buxhetore në zbatim të kontratës koncesionare. Qeverisja qendrore ka mbështetur në formën e transfertave Bashkinë e Tiranës në procesin e menaxhimit të mbetjeve.

Një moment tjetër, që u kërkuar të hetohet në komisionin hetimor, ishte edhe fakti i mbylljes së Porto-Romanos për ta shndërruar në një ekopark, si dhe trajtimi i mbetjeve të Bashkisë së Durrësit në impiantin e Tiranës. Mbyllja e Porto-Romanos është reflektuar në publik si një vendim i duhur, por edhe në rrethet akademike. Në lidhje me mbetjet e Durrësit nuk është amenduar kontrata koncesionare e Tiranës, pasi përcaktimet ligjore lejojnë që koncesionari ka të drejtë të marrë dhe të furnizohet me mbetje edhe nga njësi vendore të qarqeve të tjera. Në kushtet e një emergjencë mjedisore në Bashkinë e Durrësit është marrë një vendim i mbështetur në studimet dhe analizat e zonës Tiranë-Durrës për ta përfshirë edhe këtë bashki. Është në kompetencën e njësisë vendore të vendosë mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane për qytetin dhe në vendimmarrjen e këshillit bashkiak të Durrësit u dakordësua kostoja për trajtimin e mbetjeve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Emergjencat mjedisore kanë qenë realitete të jetës së shumë qyteteve, por nuk do të jenë më. Në vite janë prodhuar male të tëra me mbeturina, re toksike tymi që kanë hyrë në çdo shtëpi e çdo organizëm të qytetarëve, pavarësisht besimit dhe vetëbesimit politik. Po kështu, për javë e muaj të tërë në këtë komision u prodhuan male me të pavërteta, akuza me gënjeshtër, re toksike për shuma të së ardhmes të vjedhura sot, duke fabrikuar mbetje politike, të cilat janë vështirë të pastrohen, por ndotin mendjen e të gjithë qytetareve. Kostoja e heqjes së tyre, që gjithsesi, bën pis edhe ata që i bëjnë, është e jashtëzakonshme. Megjithatë, politika e ka impiantin e saj ditën e zgjedhjeve, në kutitë e votimit ku shqiptarët ndajnë të dobishmen nga e padobishmja dhe riciklojnë, dhe rezultati i 6 marsit e vërtetoi këtë fakt edhe një herë tjetër me kokëfortësi. Qëllimi për të fituar kredo politike nuk duhet të ndodhë mbi një temë që, në fakt, duhet të na shqetësojë ne të gjithë si qytetarë dhe parlamentarë, pasi ka procese dhe objektiva të rëndësishme për t'i adresuar për të ardhmen.

Me këtë perspektivë, jam shumë e kënaqur, në fakt, që sot 3 ministri, ajo e Mjedisit dhe Turizmit, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Rinisë kanë nisur hartimin e një plani të riciklimit, i cili do të zbatohet fillimisht për Bashkinë e Tiranës dhe më pas në të gjithë vendin. Plani i riciklimit synon të fillojë ndarjen e mbetjeve në burim dhe të riciklojë kryesisht mbetjet e plastikës dhe letrës në shkollat dhe institucionet publike. Mjedisi sot është cilësi jete, është objektiv i zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2020, është ekonomi, është turizëm, është imazh, por, mbi të gjitha, është civilizim dhe këtë të fundit ua kemi detyrim fëmijëve tanë. Në mbyllje, dua të ritheksoj se, si anëtare e maxhorancës në këtë komision, por edhe si qytetare e angazhuar, mirëpres çdo rezultat të punës së organit të akuzës, gjetjet e rezultateve të hetimit në raport me dokumentet e administruara dhe hetimet e ndjekura, por duhet ta lëmë atë të shprehet. Faleminderit!